

## **STATUTI I SHOQËRISË**

### **"CODESK DESIGN" SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 21/07/2021, me cilësinë e Ortakut të Vetëm Znj.Sonila Beqiri, e bija e Beqirit, lindur më 14/10/1975 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal AT 9314785 , e cila në cilësinë e "Ortakut të vetëm", me vullnet të lirë dhe të plotë, mbështetur në legjislacionin në fuqi ortaku i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin: "**CODESK DESIGN" SHPK** më poshtë e quajtur "Shoqëria", miraton Statutin e Shoqërisë me përbajtje si më poshtë vijon:

### **KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Themelimi, Forma dhe Emërtimi I Shoqërisë**

Krijohet shoqëria "**CODESK DESIGN" SHPK** Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar.

Shoqëria do të paraqitet me emrin "**CODESK DESIGN" SHPK**. Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjitha regjistrime, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si Jashtë dhe brenda vendit.

Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.


Shoqëria ka vulën dhe logon e saj identifikuase, në formën dhe me ekstremitetet e caktuara nga Ortaku i Shoqërisë.

Akti I Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që është i detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

#### **Neni 2 Themeluesi**

Shoqëria është themeluar nga:

Znj.Sonila Beqiri i cili është Ortaku i vetëm i shoqërisë.



### **Neni 3**

#### **Objekti I veprimtarisë së shoqërisë**

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë:

"Objekti i veprimtarisë së shoqërisë konsiston në kryerjen e të gjitha veprimtarive të pranuara dhe të ligjshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktiviteti kryesor i shoqërise do të jetë: Disenjim software; Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software; Testim software; Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit; Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurise; Zhvillim sistemesh migrimi; Përmiresim /upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i perdonimit, trajnimi dhe auditimi Teknik/informatik për sistemet software; Shërbime Marketingu dhe telemarketingu. Konsulencë në fushën Informatikës elektronikës dhe telekomunikacionit; Shërbime informatike. Projekte arkitektonike në objekte civile, industriale, objekte sportive, projektim interiere, projektim peizazhi, sistemim siperfaqe të gjelbërtë. Konsultime në fushën e arkitekturës. Supervizim në fushën e arktitekturës.

Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryeje cdo operacion tregtar dhe finansiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të tjera, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesmarrjen në sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryej edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi".

### **Neni 4**

#### **Selia e shoqërisë dhe degët**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën: Rr. Jakov Xoxa, Pallati 26/2, Shkalla 4, Ap2, Tiranë.

Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjeter do të behet me vendimin e Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.

Zyrat, filialat, degët apo agjensitë krijohen me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë "CODESK DESIGN" SHPK është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakut të shoqërisë.

Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të ortakut të shoqërisë.

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR**  
**Neni 6**

Kapitali themeltar I shoqërisë është 100,000 lekë (Njëqind mijë) lekë dhe përbëhet nga 1 kuotë e vetme me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

*Ortaku themelues i Shoqërisë "CODESK DESIGN" SHPK, Znj. Sonila Beqiri është zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.*

**Neni 7**  
**Ndryshimi I kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar I shoqërisë mund të zmadhohet apo të zgjedhohet vetëm me vendimin e Ortakut të shoqërisë. Në çdo rast kapitali nuk mund të zgjedhohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.


Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike i përkasin Ortakut, por kurdoherë pasi të janë shlyher detyrimet ligjore.

Shoqëria "CODESK DESIGN" SHPK është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë e të shfrytëzoj të drejta të tjera material ose jo material duke përfshirë edhe të drejtën e shitjes së pasurisë së vet tek të tretët.

Shoqëria "CODESK DESIGN" SHPK vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku themelues I shoqërisë mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm deri në nivelin e kapitalit të investuar në të.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nëpërmjet aktve ligjore.



## KAPITULLI III

### ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

#### Neni 10

##### Organë Vendimarrës

1. Asambleja e Përgjithëshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për cështjet e mëposhtëme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimin e Statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve;
- Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;
- Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për cështjet e përcaktuar për miratimin e pasqyrave financiare, as marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku I Vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku I Vetëm regjistrohen në një regjistrer të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen apo të fshihen. Duhen regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investime;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund ti kundrejtjorë pavleshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèc rastit kur shoqëria provon se I treti ka pasur dijeni për pavleshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

4. Ortaku I Vetëm mund të përfaqëson edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

5. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit.

#### Neni 11

##### Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, ose nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik, duhet



të përbajë vendin, datën orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2.Kur Asambleja e Përgjitheshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarsisht parregullsisë.

**Neni 12**  
**Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e Statutit vendosen nga Ortaku I Vetëm.

Cdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë Qendrës Kpmbëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 13**  
**Administrimi**

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

Ortaku I Vetëm vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrative me shumë administrator, përcakton numrin e tyre dhe kompentencat.

Administrator/rët mund të jetë ose jo ortak të shoqërisë.

Administrator mund të shkarkohet në cdo kohë.

Administratorët e shoqërisë janë Znj.Sonila Beqiri e cila do të ushtrojë kompetencat e tij në këtë detyrë për një periudhë pesë vjecare sipas ligjit, dhe Znj.Sandra Agaj e cila do të ushtrojë kompetencat e tij në këtë detyrë për një periudhë një vjecare sipas ligjit.

**Neni 14**

Shoqëria administrohet nga Administratorët: Znj.Sonila Beqiri, e bija e Beqirit, lindur më 14/10/1975 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal AT 9314785, dhe Znj.Sandra Agaj, e bija e Muharem, lindur më 19/07/1990 në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal J15719069U.

Administrator ka të drejtë e detyrohet të:

- Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Kujdeset përmbytje saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, I paraqet këto dokumente përparrë Asamblesë së Përgjithshme përmiratim;
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojë përparrë Asamblesë së Përgjithshmenë lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



- Përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve;
- Administrator angazhon shoqërinë në marrdhënet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj;
- Administrator ka të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshirë këtu kontratat e qerasë, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak;
- Të nënshkruaj e të hartojë cdo document e të kryejë në emër të Shoqërisë cdo veprim përballetë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me celjen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimi i kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit;

### **Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga oratku i vetëm që I sjellin dëm shoqërisë, I ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përvèc padisë për shlyerjen e dëmit që I ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngre padi penale kundër administratorit.

Ortakët kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që I është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në cdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti financiar I Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Përashtimisht viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

### **Neni 17 Bilanci I Shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos rreth shpërndarjes së fitimit neto, fitim I cili pasqyrohet nga pasqyrat financiare vjetore, pasi të janë zbritur humbjet e vitit të mëpëershëm financiar, sic edhe parashikohet nga ligji gjithashtu edhe pasi të janë zritur të gjitha shumat që Asambleja e



Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka vendosur të lërë mënjanë, I shpërndahet Ortakut të Vetë të Shoqërisë.

Asambleja vendos nëse do të mbajë ose jo shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve neto të përcaktuara në pasqyrat financiare vjetore, tërësisht apo pjesërisht, në vitet ushtrimore pasardhëse.

**Neni 18**  
**Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë I ngarkuar nga ana e Ortakut të Vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël I autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është I detyruar që t'ja dorëzoj në kohë Ortakut të Vetëm për t'l shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Neni 19**  
**Bilanci**

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga Ortaku I Vetëm, e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.

**Neni 20**  
**Shpërndarja ose prishja e shoqërisë**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë, mund të ndodh në çdo kohë dhe për një nga shkaqet që vijojnë:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë;
- Pamundësi veprimi;
- Me vendim të Ortakut të Shoqërisë.

Në këto raste, Ortaku I shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke iu përcaktuar dhe kompetencat.

Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë përderisa ajo tu dorëzohet personave përkatës fizik dhe juridik, duke likuiduar në rradhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria. Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund ti kërkojë ortakut të shoqërisë që të kontribuoj me të gjitha kuotat e tyre për të përmbrushur detyrimet me të tretët.



Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, Ortaku cakton një likuidator, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar.

Likuidatori I emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është I detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe ta vendlodë atë në dispozicion të Ortakëve.

Me caktimin e likuidatorit pezullohen të gjitha kompetencat e Administratorit dhe ato I kalojnë likuidatorit.

### **Neni 21** **Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t’I kalojë trashgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t’I kalojë trashgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja. Ortaku I vetëm I shoqërisë, që bën kalimin e trashgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura më lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 përqind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen ndërmjet shoqërise të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohësish për ortakët e shoqërise që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërise përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

### **KAPITULLI IV** **LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 22** **Emërtimi I likuiditorit**

Afat I emërimit të likuiditorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozitar në Aneksin e Regjistrat Tregtar.

#### **Neni 23** **Likuidimi**

Likuiditori është I detyruar të jetë I vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecantë apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

## **KAPITULLI V DISPOZITAT E FUNDIT**

### **Neni 24 Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqipar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 25 Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 26 Dispozita përfundimtare**

Ky statut u hartua në 4 kopje me përbajte dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare “**CODESK DESIGN**” SHPK nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË  
SONILA BEQIRI**

